



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 27 paragrafi 1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datë 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar kundër vendimit të refuzimit për mbështetje financiare për vitin 2026. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
    - 1.1. Dr. Eshref Kryeziu, specialist i mjekësisë familjare,.....nga QKMF, kryesues,
    - 1.2. Fatlinda Ukaj, zyrtare e lartë ligjore, .....nga DSh, anëtare,
    - 1.3. Bardha Kastrati, zyrtare e lartë për statistika shëndetësore....nga DSh, anëtare,
    - 1.4. Driana Destani, zyrtare për buxhet dhe financa,.....anëtare rezervë,
  2. Detyrat e Komisionit, të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi janë që një afati sa më të shkurtër kohor të bëjë:
    - 2.1. Shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave kundër vendimit të refuzimit për mbështetje financiare për vitin 2026, konform Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve.
    - 2.2. Marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me aprovimin dhe refuzimin e mbështetjes financiare bazuar në ankesat e trajtuara.
  3. Mandati i Komisionit do të zgjat deri me 31.12.2026.
  4. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
  5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Komisionit,
  - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

